

Çfarë janë Qendrat për Drejtësinë Familjare?

Qendrat për Drejtësinë Familjare në qytetin e Nju Jorkut: Brooklyn, Bronx, dhe Queens janë qendrat për viktimat e dhunës shtëpiake si dhe për fëmijët e tyre ku mund të vihet pa lënë takim. Për ta bërë më të lehtë për të marrë ndihmë, në Qendër ndodhen edhe shumë agjenci. Shërbimet janë falas dhe në dispozicion për të gjitha viktimat. Ne mund t'ju ndihmojmë ju pavarësisht nga gjuha që flisni.

Kur të vizitonit Qendrën, ju mund të prisni një mjedis ku mbizotëron siguria dhe përkujdesja, me shërbime dhe ndihma direkte per ju. Në vizitën tuaj të parë në Qendër, ju do të takoheni me një specialist të klientit, që do të ju flasë për shërbimet që mund të keni nevojë. Specialisti i klientit më pas do t'ju lidhë me një menaxher për çështjen tuaj, i cili do të jetë drejtuesi juaj në Qendër.

Çdo Qendër ndodhet në ndërtesa me roje mbrojtës për të siguruar mbrojtjen tuaj. Ju duhet të shkoni tek tryeza e personelit të sigurimit në lobi për të shënuar emrin. Më pas do t'ju kërkohet që të kaloni nëpër aparatin e kontrollit (detektorin e metalit) perpara se të hyni në Qendër. Lutemi të sillni dokument identifikimi me foton tuaj.

ÇDO NJERI ka të drejtë të jetojë në shtëpi ku të ndihet i mbrojtur. Ju nuk jeni e vëtmuar. Qendrat për Drejtësinë Familjare në qytetin e Nju Jorkut janë këtu për t'ju ndihmuar juve.

Si mund të më ndihmojnë mua Qendrat për Drejtësinë Familjare?

MENAXHIMI I ÇËSHTJES Ju mund të takoheni me menaxherin/en e çështjes për të diskutuar si të qëndroni të mbrojtur, dhe të mësoni se me çfarë shërbimesh Qendra mund t'ju ndihmojë juve.

KONSULTIM Konsultimet jane në dispozicion për ju dhe për fëmijët tuaj. Qendra ka në dispozicion konsultimet: individuale, dhe ne grupe ndihmues.

INFORMACION LIGJOR Avokatët dhe punonjësit ligjorë janë ne dispozicion për të biseduar me ju rreth çështjeve ligjore, si p.sh. kujdestaria dhe vizitat e fëmijëve, dhe emigracionit.

POLICIA Oficerët e Parandalimit të Dhunës Shtëpiake nga Departamenti i Policisë te qytetit Nju Jork në Qendër do t'ju ndihmojnë juve në raportimin e krimit, ose do t'ju japin informacion se si policia mund t'ju ndihmojë për të qenë të mbrojtur.

LIRIMI ME KUSHT Oficeri i lirimt me kusht mund t'ju ndihmojë nëse personi që po ju lëndon është në lirim me kusht.

NDJEKJA PENALE Byroja e Dhunës Shtëpiake e Zyrës së Prokurorit ndodhet në Qendër dhe do të bashkëpunojë me ju, pasi dhuna shtëpiake është krim. Prokurorët mund t'ju përgjigjen çdo pyetje që mund të keni për sistemin në drejtësisë kriminale.

DHOMA E FËMIJËVE Fëmijët tuaj, nga mosha tre vjeç e sipër, mund të luajnë në Dhomën e Fëmijëve, gjatë kohës që ju kërkon ndihmë në Qendër.

SHËRBIMET E ABUZIMIT TË TË MOSHUARVE Punonjësit socialë, avokatë, dhe prokurorë Jane ketu për t'ju ndihmuar nëse po përjettoni abuzim si i moshuar.

SHËRBIMET E VETË-MBËSHTETJETES Kordinatori i Vetë-Mbështetjes mund t'ju ndihmojë me informacion për asistencën sociale, trajnim për punë, dhe programe arsimore.

NDIHMA SHPIRTËRORE Vullnetare drejtues të besimeve fetare janë në Qendër t"ju ofrojnë ndihmë, nëse ju e kërkon atë.

Drejtimi

Qendra e Drejtësisë Familjare është një qendër ku mund të vini pa caktuar takim. Nëse ju ktheheni përsëri për vazhdimin e shërbimeve, duhet të lini takim në listën e numërave të shënuara më poshtë.

BRONX FAMILY JUSTICE CENTER 198 East 161 st Street, 2 nd Floor Bronx, NY 10451	BROOKLYN FAMILY JUSTICE CENTER 350 Jay Street, 15 th Floor Brooklyn, NY 11201	QUEENS FAMILY JUSTICE CENTER 126-02 82 nd Avenue Kew Gardens, NY 11415
ME TREN: Merrni trenin 4, D, ose B për në stacionin "161st Street Yankee Stadium". Zbrisni afér kryqëzimit në "East 161st Street" dhe "River Avenue". Ecni në lindje në "161st Street" në drejtim të "Grand Concourse". Qendra ndodhet në qoshen e "E. 161st Street" dhe "Sheridan Avenue".	ME TREN: Merrni trenin A, C, F ose R për në "Jay Street/Metro Tech"; merrni trenin 2, 3, 4, ose 5 për në "Borough Hall".	ME TREN: Merrni trenin F ose E për në "Kew Gardens/Union Turnpike." Daljen nga stacioni bëjeni në "Court House/North Side" dhe ecni për në lindje të Queens Boulevard, dhe pasi të kaloni Queens Borough Hall, kthehuni majtas për në 82 Avenue – Qendra është në anën e majtë të rrugës.
ME AUTOBUS: Të gjithë autobusët me numër B25, B26, B38, B51, B54, B57, B61, B65, B67, dhe B75 ndalojnë pranë Qendrës.	ME AUTOBUS: Të gjithë autobusët me numër B25, B26, B38, B51, B54, B57, B61, B65, B67, dhe B75 ndalojnë pranë Qendrës.	ME AUTOBUS: Të gjithë autobusët me numër Q10, Q37, Q46, dhe Q60 ndalojnë pranë Qendrës.
ORËT E SHËRBIMIT: Qendra hapet nga dita e Hënë e deri të Premten, ora 9 paradite deri ne oren 5 mbasdite.	ORËT E SHËRBIMIT: Qendra hapet nga dita e Hënë e deri të Premten, ora 9 paradite deri ne oren 5 mbasdite.	ORËT E SHËRBIMIT: Qendra hapet nga dita e Hënë e deri të Premten, ora 9 paradite deri ne oren 5 mbasdite.
PËR TË CAKTUAR NJË TAKIM NË VAZHDIM TELEFONONI: (718) 250-5111		PËR TË CAKTUAR NJË TAKIM NË VAZHDIM TELEFONONI: (718) 575-4500
TELEFONONI: (718) 508-1222		

Partnerët n'' qendër

The Arab American Family Support Center/Tamkeen
Barrier Free Living
Bronx County District Attorney's Office
Bronx Legal Aid Society
CAMBA
Center Against Domestic Violence
Day One
The Financial Clinic
Good Shepherd Services Safe Homes Project
inMotion, Inc.
Jewish Association for Services for the Aged
Jewish Board of Family and Children's Services

Kings County District Attorney's Office
Korean American Family Service Center
Legal Services NYC
Metropolitan Council on Jewish Poverty
Mount Sinai Sexual Assault and Violence
Intervention Program
New York Asian Women's Center
New York City Anti-Violence Project
New York City Department of Information
Technology and Telecommunications
New York City Human Resources
Administration

New York City Police Department
Queens County District Attorney's Office
Queens Legal Services
Safe Horizon
Sakhi for South Asian Women
Sanctuary for Families
Sauti Yeti Center for African Women
Shorefront Y
South Brooklyn Legal Services
Urban Justice Center
Violence Intervention Program, Inc.
W!SE (Working in Support of Education)

Të jeni të sigurt e të mbrojtur

Nëse jeni duke u keqtrajtuar, merrni këto masa ndihmuese që të qëndroni të sigurt e të mbrojtur:

- Telefononi 911 nëse jeni në rrezik ose jeni demtuar nga partneri juaj.
- Mësoni fëmitë tuaj të përdorin telefonin për të telefonuar policinë, dhe shkoni në një vend të sigurt gjatë incidentit dhunues.
- Caktoni që më parë një vend të sigurt për të shkuar në rast urgjent, si p.sh. stacioni i policisë së zonës.
- Mbyllni të gjitha dritaret dhe dyert natën, dhe kur largoheni nga shtëpia.
- Informoni shkollën apo kopshtin e fëmijëve tuaj se kush ka leje për t'i marrë fëmitë tuaj.
- Kërkonit ndryshimin e numrin tuaj të telefonit në numër jo të regjistruar.
- Mbani adresën e shtëpisë suaj të fshehtë dhe nëse është e mundur, mos i tregoni abuzuesit se ku jetoni.
- Mundohuni te mos shkoni vetëm jashtë.
- Ndryshoni shpesh here rrugën kur shkoni dhe ktheheni nga puna.
- Nëse është e mundur, në punë lini një person tjeter që të kontrollojë më parë se nga vijnë telefonatat për ju, dhe

kërkonit që numri i telefonit të zyrës dhe adresa juaj elektronike e internetit (e-mail) të ndryshohet, si dhe ndryshoni orarin e punës.

- Në rast se ju duhet të largoheni shpejt, ju duhet të mblidhni dokumentet e rëndësishme:
 - Pasaportë/Kartë qëndrimi/Autorizimi punës
 - Karta e numërit të punës/Certifikata e lindjes
 - Letrat e llogarive bankare/tapia/kontrata e qirasë së shtëpisë
 - Urdhëresa Gjykatës për Mbrojtjen
 - Urdhërrera e Gjykatës për Kujdestarinë e fëmijëve/Urdhëresa për vizitimin e tyre
 - Çertifikata e Martesës
 - Kartat mjekësore e vaksinimeve/dokumentet e shkollës të fëmijëve
 - Libri i adresave dhe një kartë telefonike
- Paketoni një çantë me para, çelësa shtesë, rroba, ilaçet mjekësore, dhe dokumentet e rëndësishme – vendoseni në një vend të sigurt ose me dikë që ju e besoni.

Nëse ju ose dikush që ju njihni është viktimi e dhunës shtëpiake, ndihma është në dispozicion.

Në rast urgjencë, telefononi 911

Për shërbime të tjera qytetare, telefononi 311

Linja telefonike e posaçme për Dhunës Shtëpiake në qytetin e Nju Jorkut

1-800-621-HOPE (4673)1-866-604-5350 (TDD-Pajisje telekomunikimi për të shurdhët)

Të gjitha më lart ofrojnë shërbime 24-orë pa ndërprerje, e në të gjitha gjuhët.

BURIME TË TJERA NDIHMËSE

Linja telefonike e posaçme për abuzimin dhe keqtrajtimin e fëmijës (New York State Central Register), 1-800-342-3720

Qendra e Ndihmës për Viktimat e të Moshuarve (NYC Department for the Aging), 212-442-3103

Linja telefonike e posaçme për Emigracionin në Nju Jork 1-800-566-7636

Linja telefonike e posaçme për Raportimin e Krimit Seksual në Departamentin e Policisë së Nju Jorkut, 212-267-RAPE (7273)

Informacioni i viktimës dhe Njoftimi i perditçem (Victim Information & Notification Everyday) (NYC Department of Correction), 1-888-VINE-4NY (846-3469)

Lidhja për të Rinjtë (Youth Connect) (NYC Dept. of Youth and Community Development), 1-800-246-4646



Michael R. Bloomberg
Mayor

**Mayor's Office to
Combat Domestic
Violence**

Yolanda B. Jimenez
Commissioner

www.nyc.gov/domesticviolence



Printed on paper containing 30% post-consumer material.